

Banka Për Biznes, Zyra Qendrore shpall konkurs për pozitën:

KONKURS

Auditor i brendshëm i Lartë (f/m)

Kualifikimet:

- Kualifikim Universitar në kontabilitet, financa apo në një fushë tjetër të ngjashme;
- Përvojë minimale prej tre (3) vite në Auditim të brendshëm/jashtëm, preferohet nga to së paku dy (2) vite përvojë pune me institucione financiare;
- Kontabilist apo auditor i çertifikuar dhe anëtar i një shoqate kombëtare apo ndërkombëtare profesionale në fushën e kontabilitetit apo auditimit;
- Njohuri dhe përvojë lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF);
- Aftësi të mira analitike, komunikuese dhe prezantuese;
- Aftësi të mira të punës në ekip si dhe në mënyrë të pavarur;
- Njohja e Gjuhës Angleze dhe përdorimit të Microsoft Office-it.

Përgjegjësitë:

- Planifikon dhe kryen auditimet sipas Statutit, Politikës dhe Procedurës së Auditimit të Brendshëm në Bankë dhe në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm;
- Analizon të dhënat financiare dhe jo-financiare për të identifikuar modelet ose trendet e pazakonta për departamentet dhe proceset e ndryshe të Bankës, për qëllim të identifikimit të rreziqeve të ndryshme;
- Zhvillon dhe monitoron programet e auditimit për të vlerësuar rreziqet dhe kontrollet e brendshme në bazë të planit vjetor të auditimit dhe kërkesave specifike;
- Rishikon dhe kryen teste të kontrollit dhe testime të pavarura, për të siguruar evidencë të mjaftueshme të auditimit të dokumentuar dhe strukturuar mirë;
- Ekzaminon dhe vlerëson përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Rishikon sistemet e menaxhmentit dhe të informacioneve financiare, përfshirë sistemin elektronik të informacioneve dhe shërbimet elektronike bankare;
- Rishikon saktësinë dhe besueshmërinë e regjistrave të kontabilitetit dhe të raporteve financiare për qëllime të rregullatorit, SNRF, etj.;
- Vlerëson ekonomikitetin, efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve dhe proceseve;
- Rishikon sistemet e themeluara për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullative, kodin e sjelljes dhe implementimin e politikave dhe procedurave;
- Rishikon zbatueshmërinë e politikave dhe procedurave të brendshme të bankës për procese të ndryshme;
- Komunikon në mënyrë efektive rezultatet e auditimit të kryer me personat përgjegjës të njësisë/degës/procesit dhe jep rekomandime rreth veprimeve që duhet ndërmarrë për adresim të gjetjeve;

- Sistemon dhe kryen indeksimin e letrave të punës dhe dokumentacionit relevant të auditimit;
- Përpilon draft raportet për auditimet e kryera, si dhe raportet tjera administrative në baza mujore, tremujore dhe vjetore tek menaxhmenti i departamentit;
- Monitoron implementimin e rekomandimeve të dhëna nga raportet e auditimit;
- Mbetet kompetent në fushën e auditimit dhe sektorin financiar përmes vet iniciativës për zhvillim profesional , informim, dhe ndarjen e njohurive profesionale me anëtarët e tjerë të auditimit;
- Tregon gatishmëri për ndjekje të trajnimeve për zhvillim profesional që mbështeten nga Banka;
- Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesave të departamentit dhe menaxhmentit të auditimit.

Procedura e aplikimit:

Plotësoni formularin për aplikim i cili gjendet në këtë link: <https://www.bpbbank.com/forma-e-aplikimit-per-punesim/>

Pas seleksionimit të dokumentacionit do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë.

Afati i aplikimit është deri me datë: 29/03/2019